



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS

BUXHETIT DHE MFK

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

INFORMACION MBI ECURINË E REALIZIMIT TË TREGUESVE KRYESORË TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE, PËR PERIUDHËN JANAR-MAJ 2023

Në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.84/2022 datë 21.12.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, VKB nr. 183 datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë, si dhe VKB nr. 24 datë 09.02.2023 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2022 të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2023”, po ju informojmë në lidhje me ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, për periudhën janar-maj 2023.

Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2023 është planifikuar në vlerën **2,271,851** mijë lekë dhe realizimi për periudhën janar-maj 2023 është **583,692** mijë lekë ose **26%** dhe krahasuar me planin 5 mujor në vlerën **1,099,211** mijë lekë realizimi është **53%**. Paraqitja e informacionit duke e krahasuar me të njëjtë periudhë të vitit 2022 jepet si më poshtë:

000/lekë

Plan 2022	Fakt 5M 2022	%	Plan 2023	Fakt 5M 2023	%
2,085,625	552,339	26%	2,271,851	583,692	26%

Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për Bashkinë dhe Institucionet e Varësisë është 317,801 mijë lekë ose realizuar në masën 27% kundrejt planit të vitit 2023 në vlerën 1,192,786 mijë lekë. Paraqitja e informacionit duke e krahasuar me të njëjtë periudhë të vitit 2022 jepet si më poshtë:

000/lekë

Plan 2022	Fakt 5M 2022	%	Plan 2023	Fakt 5M 2023	%
1,062,056	326,406	31%	1,192,786	317,801	27%

Detajimi i buxhetit sipas llogarive ekonomike dhe Institucioneve të Varësisë, i krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi i llogarive	PLAN 2022	FAKT 5M 2022	PLAN 2023	FAKT 5M 2023	Dif 23-22	% Fakt 5M 23-22
Shpenzime personeli 600-601	755,018	276,904	843,133	316,769	39,865	14%
Shpenzime korrente 602-609	914,242	245,365	956,319	208,410	-36,955	-15%
Shpenzime per investime 230-231	371,195	18,864	429,538	48,706	29,842	158%
Pagesa e principalit dhe interest 166-651	45,170	11,206	42,861	9,807	-1,399	-12%
TOTAL BASHKIA+INST	2,085,625	552,339	2,271,851	583,692	31,353	6%

000/lekë

Institucionet	PLAN 2022	FAKT 5M 2022	PLAN 2023	FAKT 5M 2023	Dif 23-22	% Fakt 5M 23-22
BASHKIA	1,011,346	222,613	1,072,041	243,411	20,798	9%
NSHMAC	430,874	150,068	489,843	141,430	-8,638	6%
NSHP	503,824	135,246	564,846	147,385	12,139	9%
QAK	87,257	24,795	87,313	29,966	5,171	21%
QDZH	500	0	550	0	0	0
QRZH	420	158	655	156	-2	-1%
KLB SHSP	46,029	18,715	51,044	20,689	1,974	10%
SHTP E FOSH NJËS	5,375	744	5,559	655	-89	12%
TOTAL BASHKIA +INST	2,085,625	552,339	2,271,851	583,692	31,353	6%

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë planifikuar në vlerën 843,133 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 316,769 mijë lekë ose 37%.

Shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 956,319 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 208,410 mijë lekë ose 22%.

Shpenzimet për investime janë planifikuar në vlerën 429,538 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 48,706 mijë lekë ose 11%.

Shpenzimet për principalin dhe interesin janë planifikuar në vlerën 42,861 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 9,807 mijë lekë ose 23%.

Bashkangjitur:

Tabela nr. 1 e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, dhe të ardhurat e Institucioneve të Varësisë për periudhën janar-maj 2023.

Tabela nr. 2 e realizimit të shpenzimeve nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për periudhën janar-maj 2023.

Tabela nr. 3 e realizimit të shpenzimeve nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për periudhën janar-maj 2023

Tabela nr. 4 e realizimit të shpenzimeve nga të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore dhe sponsorizimet për periudhën janar-maj 2023

Tabela nr. 5 e detajimit të shpenzimeve operative (detyrime 2022) që kanë si burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, transfertën e pakushtëzuar të ardhurat e trashëguara nga taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore të vitit 2022 si dhe sponsorizimet.

Tabela nr. 6 e detajimit të shpenzimeve për investime (detyrime 2022) që kanë si burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, transfertën e pakushtëzuar të ardhurat e trashëguara nga taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore të vitit 2022 dhe sponsorizimet.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS
BUXHETIT DHE MFK
Valbona ZIKO

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE
E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
Anxhela (QERAMIXHI) DISHNICA

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
Soniel PRIFTI

KRYETARI I BASHKISË
Sotirag FILO